



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 157, Datë 07.10.2020**

**“MBI**

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “YLLIAD” SH.P.K, NR. 9, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S, NR. 97, DATË 28.07.2015”.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 13 dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE- s nr.109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 07.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 105/2, datë 30.09.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për rinovimin e licencës së shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 139, datë, 21.08.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “YLLIAD” sh.p.k..
- Me shkresat nr. 1013/2 Prot, datë 26.08.2020, si dhe nr.1013/5 prot, datë 22.09.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar si dhe evidentoi nevojën për informacion shtesë.
- Me shkresën e datës 10.09.2020, protokolluar në ERE me nr. 1013/4 prot, datë 11.09.2020, si dhe me e-mailin e datës 23.09.2020, shoqëria ka përcjellë në ERE dokumentacionin e plotësuar e po ashtu, në këtë shkresë shoqëria është shprehur se pas një rishikimi të dokumentacionit të depozituar për qëllime të këtij aplikimi, ka kërkuar që të merret në konsideratë kërkesa e saj për të ndryshuar një pjesë të dokumentacionit të depozituar më herët.
- Shoqëria “YLLIAD” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 17.04.2009, është e

regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk), konform Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” (QKB).

- Shoqëria “YLLIAD” sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit për rinovim licence dhe atë të rregullimit ndaj ERE-s.

Aplikimi i shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”), **është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.**
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), **është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.**
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe **plotësuar në mënyrë korrekte.**
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), **është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.**

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të rinovojë licencën nr. 9, Seria T15, të shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 97, data 28.07.2015, për një afat 5-vjeçar duke filluar ky afat, nga data 29.07.2020.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**